



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

Drejtuar: Operatorit ekonomik: “Nexhmedin Sadiku” P.F

Adresa: Kashar Rruga Egnatia, Ndërtesa nr.10, Tiranë

* * *

Tipi i Kontratës: **Kontratë për Mallra**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar**

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **Nr.REF-24386-10-14-2024**

Data e Publikimit në SPE të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit: Data 15.11.2024

¹Data e Publikimit në Buletin e Njoftimeve Publike të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit :Buletini Nr 80, datë 18 Nëntor 2024

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Nexhmedin Sadiku” P.F *NIPT-t: L71503044S*

Vlera e ofertës: 2,046,400 (dymilon e dyzetë e gjashtëmijë e katërqind) lekë pa Tvsh
OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

2. Operatori ekonomik “SARK” Sh.p.k *NIPT-t: K52531415H*

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera e ofertës: 2,247,000 (dymilion e dyqind e dyzetë e shtatëmijë)lekë pa Tvsh
OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “SARK” Sh.p.k *NIPT-t: K52531415H*

Vlera e ofertës: 2,247,000 (dymilion e dyqind e dyzetë e shtatëmijë)lekë pa Tvsh

për arsyt e mëposhtme

a) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 1 (b) përcaktohet sa më poshtë:

2.3. . Ofertuesi duhet të paraqesë:

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; perkatesisht në vleren: 49.942,16 (dyzet e nëntëmijë e nëntëqind e dyzet e dy presje gjashtëmbëdhjetë) lekë pa tvsh të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer ne numrin e llogarise se Autoritetit Kontraktor.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” shpk , është konstatuar se operatori ekonomik ka paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën 49.942 leke pra në vlerë më të vogël se vlera e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Në mbështetje të Nenit 83 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës

Sa më sipër Komisioni i vleresimit të ofertave konstaton, se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës të paraqesin formularin e sigurimit të ofertës (Shtojca 3), në të cilin është parashikuar vlera 2% e sigurimit te ofertës përkatësisht 49.942,16 (dyzet e nëntëmijë e nëntëqind e dyzet e dy presje gjashtëmbëdhjetë) lekë. Komisioni i vleresimit të ofertave, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “SARK” shpk konstaton, se ky i fundit, për të plotësuar kriterin e mësipërm ka dorëzuar dokumentin formulari i sigurimit të ofertës, në të cilin parashikohet se “...Ky sigurim është ne vlerën 49.492 (dyzet e nëntëmijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy) lek pra më e vogel se vlera e

përcaktuar dhe gjithashtu me e vogël se vlera prej 2% e fondit limit. Sa më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej komisioni sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me dokumentat e tenderit të vëna në dispozicion nga autoriteti kontraktor dhe me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Thënë kjo operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, pika 1, germa (b).

b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë pika 2.1.2 përcaktohet sa më poshtë:

2.1.2 Operatori ekonomik ofertues në rastin kur është prodhues duhet të paraqesë Certifikatat e sigurisë dhe të perdorimit të pajisjeve në ambientet e jashtme dhe të sigurta në perdorim sipas normave Europiane **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)**. Në rastet kur nuk është prodhues, duhet të paraqesë këtë certifikatë nga prodhuesi.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “SARK” shpik konstatohet se operatori ekonomik në plotësim të këtij kriteri nuk ka paraqitur Certifikatën **S SH EN: 1176-1: 2017 (ose ekuivalente)** duke mos plotësuar kriterin përcaktuar në pikën 2.1.2

c) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë pika 2.1.1 përcaktohet sa më poshtë:

2.1.1 - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në plotësim të këtij kriteri konstatohet se certifikata ISO e paraqitur nuk përfaqëson objektin e prokurimit duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim përcaktuar sipas pikës 2.1.1.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është

përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “SARK” sh.p.k.nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: Nuk ka nënkontraktor

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: “**Nexhmedin Sadiku**” P.F, me adresë: Kashar Rruga Egnatia, Ndërtesa nr.10, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,046,400 (dymilion e dyzetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë pa Tvsh është identifikuar si oferta fituese.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga“Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, , brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Nese nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar të parashikuar në dokumentet e tenderit, apo tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do t’ju konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit, nga i cili nisin afatet e ankimit /Njoftimit të Anulimit, nga i cili nisin afatet e ankimit

PO JO

Nëse Po (Nr.__ Datë__ i vendimit përfundimtar për shqyrtimin e ankesës, të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik)